

VENDIM
Nr. 91, datë 4.2.2015

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 939, DATË 9.10.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 939, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në paragrafin II, pas fjalëve “...peshkimit dhe akuakulturës...” shtohen fjalët “... si dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore...”.

2. Në paragrafin III, pas pikës 16 shtohet pika 17, me këtë përmbajtje:

“17. Harton dhe zbaton politika në sektorin e burimeve ujore, përfshirë ujërat e brendshëm, ujërat nëntokësorë dhe ujërat detarë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama